



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Data e miratimit / Datum usvajanja / Date of Adoption: 23.01.2025		
Nr. / Br.	Shtojcë - Prilog	
15-300/01-0005079/25	PODUJEVË - PODUJEVO	



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

## DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

### RAPORTI PUNËS (Janar – Dhjetor, 2024)

Bazuar në planin e punës për vitin 2024, në vijim janë të paraqitura aktivitetet dhe punët e kryera gjatë vitit raportues.

- Monitorimi dhe zbatimi i Rregullores për Orarin e Punës për Bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës. Është përcjellur gjatë gjithë vitit zbatimi në teren në përgjithësi dhe respektimi i kujdestarive në farmacit/barnatoret në veqanti. Dy herë gjatë vitit është bërë ndryshimi i kujdestarive dhe punës të dielave pas ndryshimeve të ndodhura në teren.
- Zona Industriale – Marrëveshje bashkëpunimi me MINT në vlerë afër 4,000,000 €, janë inicuar procedurat e prokurimit dhe shumë shpejt do të fillojn punimet në ndërtimin dhe rregullimin e hapsirës për bizneset vendore dhe të huaja apo ndërkombëtare.
- Ndërtimi i Tregut të Gjelbër – Marrëveshje bashkëpunimi me MZHR është lidhur kontrata në vlerë 1,455,954.50 €, dhe kanë filluar punimet ku do të bëhet ndërtimi dhe rregullimi me qëllim që bizneset vendore/ fermerët tanë të kenë hapsira të përshtatshme për shitjen e produkteve bujqësore, në kuadër të projektit parashihet edhe ndërtimi i parkingut nëntokësor.
- Është përcjellur dhe përditësuar procesi i Listës së veqant të pronave të paluajtshme të komunës që janë planifikuar për dhënje në shfrytëzim gjatë vitit 2024. Janë ofruar informacione për palët dhe bizneset e interesuara.
- Projekti i PPP “Parkingut nëntokësor” janë zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme dhe është bërë shpallja publike.

- Është monitoruar në vazhdimësi zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025, me theks për vitin 2024. Në fund të vitit 2024 është hartuar dhe publikuar në Web-in e Komunës Raporti për Mbikqyrjen dhe Zbatimin e SZHEL-it 2023-2025 për vitin 2024.
- Janë organizuar trajnime për të rinj dhe për gratë në të bërit biznes dhe promovim të produkteve dhe shërbimeve. (AZHR, BSCK, etj).
- Në thirrjet e publikuara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, Ministria e Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, gjegjësisht KIESA janë dhënë informata dhe këshilla për mënyrën e aplikimit në këto thirrje.
- Janë lëshuar 18 çertifikata të stazhit/përvojës së punës për personat që kanë ushtruar aktivitet ekonomik në sektorin privat gjatë viteve të para luftës.
- Janë vendosur të dhënat në Programin e Investimeve Publike (PIP) në kuadër të Ministrisë së Financave (periudha 2024-2026). Numri i projekteve kapitale 109.
- Raporti i progresit në realizimin e projekteve.
- Është subvencionuar në vlerë prej 30,000€ NPL Statcioni i Autobusëve SH.A Podujevë.
- Është funksionalizuar Ndërmarrja publike “Eko Llapi” për të ofruar shërbime publike më të mira dhe me kosto më të ulët. Është siguruar hapësira e punës (në objektin e vjetër të komunës dhe ish thertorja e vjetër për paisje dhe makineri). Jemi në fazën përfundimtare të furnizimit me mjete pune Ndërmarrjen Publike Komonale “Eko Llapi” (Eskavator multifunksional, Mulqer, Autofshisë, Kamion me korp, Traktor, Makineri për deblokim të kanalizimit, Makineri për pastrim/ largim të borës, Cistern për ujitje, Trimerë dhe kositëse bari etj.) Vlera totale: Makineri 247,800€, Vegla pune 9,973€.
- Raportimi në SEMPKE – me Grupin Komunal për Raportim në Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Performancës Komonale (SEMPKE) kemi udhëhequr procesin e raportimit për vitin 2023.
- Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 gjithashtu është udhëhequr nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik. Në bashkëpunim dhe kordinim me Zyrën e Planifikimit Strategjik në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, GIZ-in Gjermanë dhe Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal janë mbajtur shumë



trajtime dhe takime. Në fundë të vitit 2024, Kryetari i Komunës e ka nxjerrë vendimin për eliminimin e 7 shërbimeve dhe reduktimin e 8 shërbimeve administrative në Komunën e Podujevës.

- Në bashkëpunim me Islamic Relief Kosova janë mbështetur 49 përfitues/e me Serra 100m<sup>2</sup> me qëllim të rritjes së prodhimit dhe një mirëqenie më të mirë ekonomike, prej tyre përfituese 5 femra dhe 44 meshkuj. Vlera totale: 53,062.50€.
- Kemi pregaditur listën e bizneseve të regjistruara sipas veprimitarisë në Komunën e Podujevës në pronësi të grave nga viti 2000 e tutje. Lista përfshinë bizneset e regjistruara, pasive dhe të shuara. Deri tani janë 457 biznese aktive në pronësi të grave, 283 pasive dhe 68 biznese të shuara.
- Janë mbështetur 91 biznese lokale duke përfshirë Start-up dhe Ekzistuese me gjithësejt 99 mjete pune (Rrobaqepësi, Automekanik, Hekrari etj.), në kuadër të thirrjes publike "Ngritja dhe zhvillimi i bizneseve". Në këtë projekt kanë qenë 37 përfituese femra si dhe 54 meshkuj, gjithashtu gjithësejt 33 kanë qenë Start-up dhe 58 biznese ekzistuese. Vlera totale: 142,200€.
- Është realizuar projekti "Riparimi i kiosqeve dhe amfiteatrit të hapur". Vlera totale: 5,000€.
- Projekti promovues për krijimin e broshurave informuese "Promovimi i potencialit turistik dhe ekonomik të Komunës së Podujevës" është realizuar. Produktet e këtij projekti janë Katalogu në figura dhe Harta turistike, Vlera totale: 13,740€.
- Në kuadër të Turizmit jemi në fazën e lidhjes së kontratës për fillimin e punimeve, projekti përfshinë rregullimin e hapsirave në fshatrat: Dumnicë e Poshtme, Kërpimeh, Bajqinë, Llapashticë dhe Sfeqël.
- Hartimi, dizajnimi dhe botimi i Strategjisë së turizmit dhe Planit të veprimit (punës) të Komunës së Podujevës 2025-2028, janë inicuar procedurat e prokurimit.
- Janë realizuar projektet, festivali veror "Ditët e Diasporës" dhe festivali i fundvitit "Ditët e fundvitit" janë dhënë në shfrytëzim shtëpizat e drurit në sheshin e qytetit, përkatësisht janë mbështetur biznese të gastronomisë dhe të prodhimit, përpunimit të prodhimeve bujqësore, artizanate dhe të natyrës së ngjajshme.

- Janë mbajtur takime me grupe dhe organizata të specializuara në fushën e turizmit me qëllim të kordinimit të aktiviteteve në këtë sektor.
- Kemi punuar në Raportimin tre mujor të projektit me Austriakët (Projekti i Huamarrjës).
- Kemi marrë pjesë në shumë puntori dhe takime, si:
  - ✓ Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Departamentin e Investimeve Strategjike;
  - ✓ Seminar një ditor të organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe OSBE. Tema: Prezantimi dhe rishikimi i Metodologjisë për vlerësimin e rreziqeve.
  - ✓ Trajnim për njoftimin e Ndhmës Shtetërore përmes SIMNSH-së të organizuar në IKAP;
  - ✓ Trajnim dy ditor lidhur me temën “Menaxhimi i Performancës” në IKAP.
  - ✓ Puntori rreth Eko-Turizmit (Projekti i ReLOaD2).
  - ✓ Aktiviteti “Qasja miqësore ndaj mjedisit përmes promovimit të eko-turizmit”, organizuar nga SDK dhe mbështetur nga BE dhe zbatohet nga UNDP.
  - ✓ Takim me përfaqësuesit e GIZ-it lidhur me projektin e tyre “Promovimi i ndërmarrësisë”, krahas kësaj kemi plotësuar dy pyetësor të tyre për vendbanimet e Zonës së Gollakut dhe Zonës Gryka e Llapit.
  - ✓ Puntori në MAPL dhe DEMOS rreth Performancës Komunale.
  - ✓ Takim konsultues me MAPL-në në lidhje me raportimin e projekteve të vitit 2023.
  - ✓ Puntori “Hartimi dhe përditësimi i Strategjive Komunale të Turizmit” të organizuar nga AKK dhe PPSE;
  - ✓ Takime në MBPZHR, ARBK dhe KIESA, etj.

- Sektori i regjistrimit të Bizneseve ka realizuar këto punë dhe aktivitete :

Nr.	Aktiviteti	Nr. i lëndëve
1.	Regjistrime të bizneseve të reja	374
2.	Shuarje të bizneseve	38
3.	Ndryshime në bizneset ekzistuese	180
4.	Certifikata të reja (me nr.unik identifikues)	49
5.	Informata	330
6.	Refuzime	11
<b>TOTALI</b>		<b>981</b>

\*Nga 374 biznese të reja, 96 janë të regjistruara me pronare Femra.

Gjithashtu zyrtarët nga Sektori i Zhvillimit Ekonomik kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të angazhuar edhe me punë shtesë në Drejtorin e Financave dhe Zyrën e Personelit, si në vijim:

- Zyrtarja për Zhvillim Ekonomik – **Zyrtari Kryesor Financiar**
- Zyrtari për Promovimin e Turizmit - **Zyrtar Shpenzues.**
- Udhëheqesi i sektorit të Ekonomisë me zyrtarë të lartë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të angazhuar me punë dhe përgjegjësi edhe në Komunën e Leposaviqit në bazë të marrëveshjes së nënshkruar nga Komuna e Podujevës me Komunën e Leposaviqit.

23.01.2025

